

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TE PRONES PUBLIKE

Blvd. Dëshmorët e Kombit Nr.2
E-mail: postmaster@mepp.tirana.al
Internet: HTTP://WWW.MEPP.GOV.AL

Tel (35542) 22979
Fax (35542) 34052

Prot.

Tiranë, më 20.11.2001

URDHER

Nr. ___ Date ___ 2001

573 23.11.

PER

Themelimin e Shoqerise "UZINA MEKANIKE" SHPK Patos


Ne mbeshtetje te nenit 2 te Ligjit Nr.8237, date 01.09.1997 " Per disa ndryshime ne ligjin Nr. 7926 dt 20.04. 1995 " Per Transformimin e Ndermarrjeve Shteterore ne Shoqeri Tregtare", ndryshuar me ligjin 8482 dt 10.05.1999 " Per nje shtese ne ligjin nr. 7926 date 20.04.1995 ", ne ligjin nr. 7638, date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregtare", dhe ne nenin 6 te Statutit te shoqerise "Albanian Petroleum Corporation " (APC) SHA Tirane

Urdheroj

1. Te themelohet shoqeria " Uzina Mekanike " Patos, me statusin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar.
2. Kapitali themeltar i shoqerise " Uzina Mekanike " SHPK Patos te jete 220.000.000 (dyqindenzetemilion) leke i ndare ne 220.000 pjese te barabarta. Kapitali themeltar krijohet nga kontributet ne natyre te shoqerise " Servcom " Sha Fier.
3. Kapitali themeltar dhe pjeset e barabarta te tij zoterohen ne masen 100% nga shoqeria kontrolluese " Albanian Petroleum Corporation " (APC) Sha Tirane.
4. Dokumentat e themelimit, Akti i Themelimit dhe Statuti i shoqerise " Uzina Mekanike " Patos, te firmosen nga Drejtori i Pergjithshem i shoqerise " Albanian Petroleum Corporation (APC) Sha Tirane.
5. Ngarkohet shoqeria " Albanian Petroleum Corporation " (APC) Sha. Tirane per zbatimin e ketij URDHERI.

Nje kopje e dokumentave te regjistrimit ne Gjykate dhe ne organet tatimore te depozitohet prane Drejtorise se Administrimit te Prones Publike ne Ministrine e Ekonomise Publike dhe Privatizimit.

Ky Urdher hyn ne fuqi menjehere.



AKT THEMELIMI



Ne baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", mbeshtetur ne Urdherin e Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit nr.573 date 23.11.2001, është vendosur :

Neni 1

Te themelohet shoqeria "Uzina Mekanike", me statusin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar.

Neni 2

Shoqeria "Uzina Mekanike" SHPK eshte shoqeri e kontrolluar, që zotërohet nga ortaku i vetëm, shoqeria "Albanian Petroleum Corporation" (APC) SH.A. Tirane.

Neni 3

Selia e shoqerise "Uzina Mekanike" eshte ne qytetin e Patosit.

Neni 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

Kryerja e projekteve, e punimeve dhe sherbimeve mekanike per industrine e naftes si dhe çdo lloj punimi e sherbimi mekanik per te trete.

Shoqeria do te zhvilloje edhe aktivitete te tjera te mundshme ne interes te shoqerise e ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 220 000 000 (dyqindenzjetmilion) leke dhe i zoteruar teresisht nga shoqeria "Albanian Petroleum Corporation"(APC) SH.A. Tirane.

Neni 6

Organet drejtuese te shoqerise jane:

- Asambleja
- Administratoret

Neni 7

Veprimtaria e organeve drejtuese te shoqerise eshte e mbeshtetur ne legjislacionin ne fuqi dhe ne normat e Statutit te shoqerise. Numri i administratorëve përcaktohet në Statut.

Neni 8

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj ne gjithë teritorin e vendit. Qendra e veprimtarisë së saj është në qytetin e Patosit, por ajo mund te kryeje sherbime, qe perfshihen ne objektin e veprimtarise, per persona të tretë ne çdo rreth te vendit.

Neni 9

Shoqeria themelohet per te vepruar ne nje afat te pacaktuar. Megjithate ajo mund te mbyllë veprimtarinë e saj me vendim të Asamblesë ose ne rastet e parashikuara me ligj.

Neni 10

Ne rast privatizmi do te respektohen dispozitat ligjore ne fuqi për privatizimin e shoqërive me kapital shtetëror.

Neni 11

Dispozita te hollesishme per veprimtarine e shoqerise percaktohen ne Statut.

SHOQERIA "APC" SH.A. TIRANE

Me urdher te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit

DREJTORI I PERGJITHSHEM

Kastriot BEJTAJ

Tirane, me2001

KASTRIOT BEJTAJ

